



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 4870 Prot

Lezhë, më 24/04 /2024

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Lezhë

Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Lezhë

Për dijeni: Kryetarit të Bashkisë Lezhë

Për dijeni: Prefektit të Qarkut Lezhë

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”, nenin 53 pika 2, pika 4, nenin 56, pika 2 shkronja “a” dhe në Rregulloren e Këshillit të Bashkisë Lezhë, e miratuar me VKB nr. 54, datë 23.04.2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë me shkresën nr.prot. 358/1, datë 15.05.2020, i ndryshuar, njoftoj thirrjen e **mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Lezhë, ditën e martë, në datën 30.04.2024, në orën 12:00, në sallën e Këshillit Bashkiak (në Pallatin e Kulturës Lezhë), me këtë**

REND DITE:

1. Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Mars 2024”
2. Projekt-Vendim “Për miratimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Bashkisë Lezhë, në kuadër të zbatimit të programit “Përmirësimi i Rezilencës së Komuniteteve”
3. Projekt-Vendim “Për përfshirjen në prioritetet e vitit 2024 të investimit për “sistemimin, asfaltimin e rrugëve rurale për vitin 2024”
4. Projekt-Vendim “Për dhënien e dakortësisë për vijimin e procedurave , për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqes së fondit pyjor në pronësi të Bashkisë Lezhë, për ushtrimin e veprimtarive të parashikuara në legjislacionin në fuqi për pyjet”
5. Projekt-Vendim “Për disa ndryshime në VKB nr. 70, datë 14.12.2023 “Për miratimin e PBA-së 2024-2026 dhe Buxhetit të vitit 2024”
6. Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të kontingjencës për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2024”
7. Projekt-Vendim “Për miratimin e kalimit me sipërmarrje të shërbimit të mirëmbajtjes së gjelbërimit për Bashkinë Lezhë”
8. Projekt-Vendim “Për miratimin e marrëveshjes së përbashkët ndërmjet Bashkisë Ugento dhe Bashkisë Lezhë për projektin “Flamuri blu - Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve privat dhe atij publik për një menaxhim efikas për ngritjen e kriterëve të standardeve për çmimin e flamurit blu në rajon”
9. Projekt-Vendim “Për miratimin e rregullores për shfrytëzimin e hapësirave publike në Bashkinë Lezhë”
10. Të ndryshme

Grafiku i mbledhjeve të komisioneve:

Nr	Komisioni	Dita	Data	Ora
1	Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Strehimit	E hënë	29.04.2024	14:00
2	Komisioni i Urbanistikës, Programeve të Zhvillimit dhe Integritit	E hënë	29.04.2024	08:30
3	Komisioni i Financës, Buxhetit dhe Zhvillimit Strategjik	E hënë	29.04.2024	09:30
4	Komisioni i Shërbimeve Publike	E hënë	29.04.2024	10:00
5	Komisioni i Bujqësisë	E hënë	29.04.2024	09:00

**KRYETARI
NDUE LULI**

